

29 janar 2014

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si kryetar i kolegjit, dhe Gjyqtarët e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta dhe Shukri Sylejmani si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtarja ligjore e EULEX-it Natalie Dawson duke vepruar në cilësi të procesmbajtëses.

Në lëndën penale kundër të pandehurve në vijim:

S.M. - Shqiptar; në paraburgim në burgun e Dubravës që nga 7 korriku 2003.

DHE

B.T. – Shqiptar; në paraburgim në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë prej 19 qershorit 2003.

Duke vendosur në lidhje me **kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë** të paraqitura nga:

- **S.M.**, të datës 30 gusht 2013
- **B.T.**, të datës 19 gusht 2013

Duke pasur parasysh mendimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPSHK-së) të datës 6 nëntor 2013.

Pas këshillimit dhe votimit, në pajtim me nenin 435 të KPP-së, Gjykata Supreme lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të datës 30 gusht 2013 dhe 19 gusht 2013 të paraqitura nga të pandehurit S.M. dhe B.T., refuzohen si të pabazuara.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës:

Të pandehurit janë akuzuar me anë të aktakuzës së parë të Prokurorisë Publike të Republikës së Kosovës PP Nr. 107/03 të ngritur më 3 dhjetor 2003, dhe me anë të aktakuzës së ndryshuar të paraqitur më 21 janar 2004, për kryerjen e veprave penale Rrëmbim i dëshmitarëve 3 dhe 4 dhe dëshmitarit F.Y. sipas neriit 64 paragrafëve (1), (2) dhe (4) të LP të RSS-së në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së. **S.M.** gjithashtu është akuzuar edhe për kryerjen e veprave penale Rrëmbim i dëshmitarit AK sipas nenit 64 paragrafëve (1) dhe (2) të LP të RSS-së në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së, dhe për veprën penale Detyrim në tentativë sipas nenit 180 LP të RSS-së në lidhje me nenet 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së.

Të pandehurit janë shpallur fajtorë për veprat penale të përmendura më lartë në shkallën e parë me anë të aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan Nr. P. 199/2003 të datës 25 qershor 2004. Ata janë liruar për veprat tjera të përmendura në aktakuzë.

M. është dënuar me 3 vite burgim për secilën vepër të Rrëmbimit, dhe 2 vite burgim për veprën penale Detyrim në tentativë. Atij i është shqiptuar dënimi unik prej 12 viteve burgim.

T. është dënuar me 5 vite burgim për secilën vepër të Rrëmbimit. Atij i është shqiptuar dënimi unik prej 7 viteve burgim.

Të dy të pandehurit kanë paraqitur ankesa kundër aktgjyqimit nr. P. 199/2003. Më 27 mars 2007, Gjykata Supreme e Kosovës ka lëshuar aktgjykimin e saj nr. AP 470/2004. Ky aktgjykim pjesërisht ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjiilan në lidhje me Rrëmbimin e dëshmitarit FY, dhe në pajtueshmëri dënimet unike, dhe në lidhje me këtë ka kthyer lëndën në Gjykatën e Qarkut për rigjykim. Gjykata Supreme ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në lidhje me veprat tjera pertaie dhe dënimet individuale për secilin, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut nr. P. 199/2003 është bërë i formës së prerë më 27 mars 2007. Gjykata Supreme ka urdhëruar Gjykatën e Qarkut që ta shqyrtoj pikën e mbetur të Rrëmbimit dhe të caktoj një dënim unik të ri.

Gjate rigjyqimit, më 4 tetor 2010, Prokurori ka tërhequr pikën e mbetur të rrëmbimit të dëshmitarit F.Y. Gjykata e Qarkut ka lëshuar aktgjykimin e saj nr. P. 181/07 më 5 tetor 2010, me të cilin ka refuzuar këtë pikë dhe ka rillogaritur dënimin. unik në pajtim me fajësinë dhe dënimin individual i cili u bë i formës së prerë më 27 mars 2007.

Të dy të pandehurit përsëri kanë paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme ka lëshuar aktvendimin e saj nr. AP 351/2010 më 25 maj 2011. Kjo ka anuluar aktvendimin nr. P. 181/07 sepse dispozitivi i aktgjyqimit nuk ka përmbajtur përshkrimin faktit të akuzës së refuzuar; nuk ka përmbajtur referencë në dënimet individuale të cilat kanë kontribuar në dënimin e shqiptuar unik; dhe nuk ka përmbajtur arsyetimin e dënimeve unike. Lënda përsëri është kthyer në rigjykim.

Më 2 dhjetor 2011, Gjykata Themelore në Gjiilan ka lëshuar aktgjykimin nr. 118/11. Tërheqja e pikës së Rrëmbimit të dëshmitarit F.Y. kundër të dy të pandehurve është vërtetuar nga Prokurori dhe aktgjykimi më tutje ka refuzuar këtë akuzë. Trupi gjykues ka shqiptuar dënimin unik në pajtim me fajësinë si dhe dënimet individuale të cilat janë bërë të formës së prerë më 27 mars 2007. **M.** është dënuar me dënim unik prej 9 viteve burgim dhe **T.** me dënim unik prej 6 viteve dhe 9 muajve burgim. Koha e kaluar në paraburgim deri në atë datë është llogaritur për secilin të pandehur.

Të dy të pandehurit kanë apeluar këtë aktgjykim në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit ka lëshuar aktgjykimin e saj nr. PAKR 907/12 më 30 prill 2013. Gjykata e Apelit ka gjetur se shpalija fajtor dhe përcaktimi i dënimeve individuale është bërë i formës së prerë më 27 mars 2007 dhe si i tillë trupi gjykues nuk ka pasur bazë ligjore që të bëjë vlerësimin e fajësisë apo dënimeve unike. Gjykata e Apelit gjithashtu ka gjetur se ligji më i favorshëm në lidhje me dënimin unik vazhdon të jetë KP i RSFJ-së. Gjykata nuk ka gjetur asnjë mangësi në vlerësimi në trupit gjykues, dhe ka vërtetuar dënimet unike të shqiptuara ndaj secilit të pandehur.

I pandehuri **M.** ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë të datës 30 gusht 2013 dhe i pandehuri **T.** ka paraqitur kërkesë të ngjashme të dates 19 gusht 2013.

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë paraqitur në bazë të arsyeve në vijim;

S.M.

Arsyet plotësisht janë të lidhura me aktgjykimin origjinal të gjykatës së shkallës së parë në vitin 2004, pasi që kanë të bëjnë me atë se kur është shpallur fajtor **M.** për veprat penale.

- a) Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe në kundërtënie me arsyetimin e aktgjykimit në tërësi.
- b) Ekzistojnë kundërtënie në mes të përmbajtjes së deklaratave dhe provave dhe arsyetimit të aktgjykimit.
- c) Mungon elementi i dashjes së veprës.

B.T.

- a) Aktgjykimi përmban dy shkelje të dispozitave ligjore. Së pari, gjykata e shkallës së parë nuk është dashur të gjykoj lëndën në bazë të veprave individuale të Rrëmbimit; por është dashur të merret me lëndën si një vepër e Rrëmbimit. Së dyti, gjykata nuk është dashur të shqiptoj dënime individuale në lidhje me secilën vepër.
- b) RSFJ-ja nuk është dashur të zbatohet, por Kodi i ri Penal (KPK-ja) dhe Kodi i ri i Procedurës Penale (KPPK-së).

Prokurori i Shtetit ka paraqitur mendimin e datës 6 nëntor 2013. Ky mendim i jep komentet në vijim:

- Gjukata Supreme ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut vetëm në lidhje me Rrëmbimin e dëshmitarit FY (27.3.2007), dhe ka vërtetuar pjesën e mbetur të aktgjykimit në lidhje me veprat tjera. Pjesa e vetme e aktgjykimit e cila ka mbetur e pazgjidhur ka qenë në lidhje me dënimet unike.
- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut ka gjetur se të dy të pandehurit kanë kryer veprat e pretenduara. Këto akte janë vepra penale të ndara sepse a to janë kryer gjatë periudhave të ndryshme kohore, kundër individëve të ndryshëm dhe nuk ka vazhdimësi të ngjarjeve.
- Gjukata drejtë ka shqiptuar dënimet individuale për secilën vepër si dhe dënimet unike.
- Dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm dhe përmban faktet vendimtare të cilat e përbëjnë veprën penale për të cilën të pandehurit janë shpallur fajtorë. Për të gjitha vendimet janë dhënë arsyet ligjore dhe faktike përkatëse.

II. Gjetjet e Gjykatës:

Pranueshmëria e ankesave

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i datës 30 prill 2013 u është dorëzuar të dy të pandehurve dhe avokatëve të tyre më 15 gusht 2013. Prandaj, kërkesat e pranuar nga Gjykata Themelore në Gjiian më 4 shtator 2013 {**M.**} dhe më 20 gusht 2013 (**T.**), janë të paraqitura me kohë (brenda tre muajve) dhe janë të pranueshme.

Kërkesat janë paraqitur par 1 janarit 2013, dhe prandaj Kodi i Procedurës Penale (KPK) është ligji procedural i cili duhet të zbatohet lidhur me këto kërkesa procedural.

Meritat e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

Fajësia dhe dënimet individuale për veprat penale për të cilat të pandehurit janë shpallur fajtores kanë marrë formën e prerë më 27.3.2007.

Më 4 tetor 2010 Prokuroria e ka tërhequr pretendimin në aktakuzë, që ishte arsyeja e anulimit të pjesshëm të aktgjykimit të parë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan (të datës 26 qershor 2004), nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës më 27 mars 2007, dhe është refuzuar nga Gjykata e Qarkut në Gjilan më 5 tetor 2010. Kjo pjesë e lëndës kishte mbaruar më 5 tetor 2010.

Kur në Gjykatën Supreme është paraqitur ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan të datës 5 tetor 2010, pjesa e vetme e këtij aktgjykimi që Gjykata Supreme konsideroi se ishte i gabuar ishte në lidhje me heqjen e detajeve dhe me gabimet në hartimin e aktgjykimit. Hartimi i aktgjykimit ishte korrigjuar nga Gjykata Themelore e Gjilanit më 2 dhjetor 2011. Gjykata Themelore e Gjilanit kishte të drejtë kur nuk ka marrë parasysh fajësitë individuale dhe dënimet individuale pasi që ato kishin marrë formën e prerë më 27 mars 2007 me vendim të Gjykatës Supreme.

Kërkesa e të pandehurit **M.** ka të bëjë krejtësisht me fajësinë dhe me shqiptimin e dënimeve individuale. Prandaj kërkesa e tij refuzohet si e pabazuar në tërësi. Kërkesa e të pandehurit lidhur me fajësinë e tij dhe me dënimin e tij për vepra të ndara penaie në vend të një vepre penale që mbulon rrëmbimin e të gjithë dëshmitarëve (si në pikën a) më lart) po ashtu refuzohet si e pabazuar për të njëjtat arsye.

Lidhur me këtë, një çështje është ngritur nga aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjiian i datës 25 qershor 2004. Sa i përket rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4, aktakuza (në paragrafin 14, faqe 4) është e qartë se rrëmbimi secilit individ duhet të formojë një pikë të veçantë. Më aktgjykimin e datës 25 qershor 2004 Gjykata e Qarkut shënon akuzat ndaj secilit të akuzuar. Rrëmbimi i dëshmitarëve 3 dhe 4 është renditur bashkë në një pikë nën [i]. Gjykata e Qarkut i ndëshkoi të pandehurit me dënime individuale për rrëmbimin e dëshmitarit 3 dhe për rrëmbimin e dëshmitarit 4. Aktgjykimi mori formën e prerë përmes vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës më 23 mars 2007. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 23 mars 2007 (faqe 3) dhe aktgjykimi me korrigjim i datës 10 mars 2010 (faqe 1 dhe 2) është i qartë se Gjykata Supreme kupton se ishin dy fajësime dhe dy dënime individuale lidhur me dy pika të veçanta të rrëmbimit të dëshmitarit 3 dhe të dëshmitarit 4.

Është e qartë për kolegjin se veprat penale janë gjykuar si pika të veçanta, dhe si të tilla Gjykata Supreme gjen se kjo qasje ishte e drejtë pasi që ato janë vepra penale individuale kundër palëve të demtuara individuale. Prandaj është e drejtë që këto të trajtohen si vepra

penale individuale. Kërkesa e të pandehurit **T.** lidhur me pikën a) si më lart, refuzohet si e pabazuar.

Pjesa e aktgjykimit të parë që nuk kishte marrë formën e prerë më 23 mars 2007 ka të bëjë vetëm me dënimin unik.

Neni 3(2) i KPP-së thotë se *'Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.'*

Gjykata e Apelit ka bërë një analizë të plotë dhe të saktë që më llogaritjen e dënimit unik të zbatohet ligji më i favorshëm. Gjykata Supreme e ka të njëjtin mendim, dhe konstaton se Kodi i RSFj-së është ligji më i favorshëm material dhe mbështet dënimet unike të shqiptuara. Kërkesa e të pandehurit **T.** e bazuar në pikën b) si më lart refuzohet si e pabazuar.

Kërkesat e të pandehurve **M.** dhe **T.** refuzohen si të pabazuara në tëresi.

Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtëse:

Gerrit Marc-Sprenger

Natalie Dawson

Gjyqtar i EULEX-it

Zyrtare ligjore e EULEX-it

Anetarët e kolegjit:

Nesrin Lushta
Gjyqtare e Gjykatës Supreme



Shukri Sytejmani
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PML 188/2013

29 janar 2014